



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 9103 Prot

Gjirokastrë më 28 : 09 : 2025

**Lënda:** Procesverbal i mbledhjes së datës 02.09.2025

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion procesverbalin e mbledhjes së dates. 02.09.2025

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot në 02.09.2025 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja po zhvillohet te mediateka pranë Universitetit “Eqrem Çabej”. Mbledhja fillon në orën 12:10

Marrin pjesë në mbledhje 21 anëtarë. Mungojnë në mbledhje: Mahmutaj, Feruni, Drasa, Manjola Shehaj, Pandos, Aliko, Rova, Llogo, Peta

Hapet mbledhja nga Znj. Isaraj Është kuorumi për fillimin e mbledhjes.

Znj. Isaraj paraqet rendin e ditës

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.07.2025
2. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01.08.2025-31.08. 2025”.
3. P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin 01.08-31.08 2025
4. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025”
5. Për një shtesë në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025” për projektin “INCREMENTAL” dhe “HERALD”.
6. P/ Vendim “Për miratimin e sipërfaqeve kullosore dhe pyjore për t’ u dhënë me qira”.
7. P/ Vendim “Për autorizimin e Bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të fondit kullosor me qëllim shfrytëzimin e energjisë së erës duke vendosur aerogjenereatorë”.
8. P/Vendim “Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Rikonstruksion i Fushës së Vjetër të Sportit”.



9.P/Vendim “Për miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”.

10.P/Vendim “Për miratimin e Planit të Menaxhimit për Transportin Publik për vizitorët vendas dhe të huaj në Bashkinë Gjirokastrë”.

11. Raporti i Drejtorisë së Arsimit për masat e marra për fillimin e vitit shkollor 2025-2026 në institucionet arsimore në varësi të Bashkisë Gjirokastrë.

12. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve.

Znj Isaraj paraqet edhe pikën shtesë të propozuar nga ekzekutivi e cila ka të bëjë me P/ VENDIM “Për përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Emergjencës Civile për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin Kolonjë”.

Znj.Isaraj ;Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro rendi i ditës.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro procesverbalit të mbledhjes së datës 31.07.2025.

Hidhen në votë dhe miratohen me 21 vota pro 2 p/vendimet e ndihmës ekonomike për muajin Korrik 2025.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%, për muajin 01-31.08. 2025”.

P/Vendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin .01-31.08.2025”.

Kalohet te pika 4 e rendit të ditës.

P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor2025”.

Flet në emër të Komisionit të Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik znj. Mihare Lapa.

Komisioni u mbledh në datë 01.09.2025 dhe trajtoi pikat 4, 5 dhe 10 të rendit të ditës dhe pasi mori përgjigjet e pyetjeve drejtuar ekzekutivit ju informon se në pikën 4 kemi të bëjmë me kthim pas të fondeve të papërdorura në lidhje me projektin “Askush të mos mbetet pas”.

Hidhet në votë dhe miratohet me 21 vota pro pika 4 e rendit të ditës. P/Vendim “Për një ndryshim në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor2025”.

Kalohet te pika 5 e rendit të ditës. “Për një shtesë në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 “Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor2025” për projektin “INCREMENTAL” dhe “HERALD”.

Znj. Lapaj: Kjo pikë ka kaluar në Komision dhe ka të bëjë me dy projekte, projekti I parë “HERALD ka filluar zbatimin në vitin 2024-2025, kurse projekti i dytë” INCREMENTAL” ka të bëjë me trashëgiminë kulturore , materiale dhe jomateriale dhe shtrihet në vitet 2025-2028.

Z. Brahimi: Shoh këtu në tabelë shpenzime për salla dhe ambiente me qira. Në kemi shumë institucione që janë mbyllur depo, ish arkivi, pse nuk rregullohen këto ambiente dhe të përdoren për aktivitetet e bashkisë?





Z. Golemi: Jemi në parashikimet e zëra dhe i kërkon projekti, por ne nuk paguajmë ambiente me qira sepse kemi sallën të QKF -ja e cila i plotëson të gjitha kriteret dhe e përdorim për takime, trajnime dhe mbledhje të ndryshme. Këto janë terma teknike që i kërkojnë projektet. Paraqet z. Eraldo Breshani disa nga projektet e fituara nga bashkia Gjirokastrë. Jemi fitues në 8 projekte nga BE dhe sapo kemi marrë konfirmimin për projektin e 9- të në bashkëpunim jo vetëm me bashki kufitare, por edhe me bashki ndërkufitare si Sllovenia. Këto projekte mbeshteten nga vende si Suedi, Finlandë, Francë, Gjermani etj. Vlera totale projekteve është rreth 800.000 euro dhe kemi aplikuar për një project me vlerë 180.000 euro.

Z. Viktor Nurçe: Unë mendoj se artizanatin nuk po e promovojmë, artizanati është pashaporta e gjirokastrës, nuk gjenden ca lekë për artizanët, për vmbështetjen e tyre.

Eraldo Breshani: Projektet që kemi aplikuar kanë pasur të bëjnë me shkëmbimin e eksperiencave. Ka projekte ku kemi lobuar për qasjen e inteligjencës artificiale dhe shkëmbimi i përvojave me artizanët.

Vjen në mbledhje Z. Qeli:

Hidhet në votë pika 5 e rendit të ditës dhe miratohet me 22 vota pro "Për një shtesë në VKB Nr.86, datë 12.12.2024 "Për miratimin e Programit Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxhetit Vjetor 2025" për projektin "INCREMENTAL" dhe "HERALD".

Znj. Isaraj paraqet pikën 6 të rendit të ditës. P/ Vendim "Për miratimin e sipërfaqeve kullosore dhe pyjore për t' u dhënë me qira".

Flet në emër të Komisionit Juridik znj. Orgesa Haska: Kjo pikë ka kaluar në komision. Është marrë statusi juridic i saj, këto sipërfaqe janë në pronësi të bashkisë Gjirokastrë. Komisioni vendosi t' i kalojë për miratim në mbledhjen e Këshillit.

Znj. Cacaj: a është bërë dëgjesa publike në lidhje me këto sipërfaqe?

Ka një udhëzim të Ministrisë së Mjedisit ku parashikohet afishimi për 45 ditë dhe më tej zbatohen procedura e ankandit dhe vazhdohet edhe me dëgjesat publike.

Z. Brahimi: Ne jemi në interes që të ketë njerëz që kërkojnë toka me qira, Kërkon fjalën në mbledhje kryeplaku i fshatit Golem z. Alket Stroka, por diskutimi që ngriti nuk kishte lidhje me pikën 6 pasi bëhet fjalë për sipërfaqe në Njësinë Administrative e Cepo.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro "Për miratimin e sipërfaqeve kullosore dhe pyjore për t' u dhënë me qira".

Znj. Isaraj: Paraqet pikën 7 të rendit të ditës. P/ Vendim "Për autorizimin e Bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim të fondit kullosor me qëllim shfrytëzimin e energjisë së erës duke vendosur aerogjenereatorë".

Shprehet në emër të Komisionit Juridik znj. Orgesa Haska: Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin. Bëhet fjalë për një sipërfaqe toke në njësinë Administrative Picar e cila ka kaluar në pronësi të Bashkisë Gjirokastrë me VKM në vitin 2022 dhe jepet për studim për energjinë e erës

Z. Golemi: Nuk e japim ne lishencën, Nuk preket kullota. Zhvillohet dëgjese publike nëse ka interes ose jo dhe lejen e marrin nga Ministria e Mjedisit, jo nga bashkia.

Z. Hilaj: Ne e kemi kaluar një project të ngjashëm. A është i njëjti ky project?

Z. Alket Stroka: Unë ju them se nuk jemi dakord dhe po shitet gur aty. Ejani dhe shikojeni.



Z.Nebiaj; Bëhet fjalë për një project që shtrihet në dy bashkitë, Tepelenë dhe Gjirokastrë. Me procedurat vazhdohet më tej pas studimit të energjisë së erës , me plan biznesi. Nga kjo sipërfaqe që kërkohet asnjë m nuk është I kontraktuar me qira.

Z. Stroka: Ka kontrata 3 – vjeçare.

Z. Brahimi: Unë mendoj se ekzekutivi që përgatit materialin dhe na e paraqet ne këtu ka kompetencën dhe mban edhe përgjegjësi dhe sqyrton dokumentacionin.

Z. Golemi: Mua më keni patur dhe me keni krah, dhe në këtë rast nuk cënohet asnjë cm kullotë, se nëse cënohet përgjegjësia është e imja. Firma është në fazë studimi.

Z. Guçe Të qartësohet që ne miratojmë fazën e studimit.

Hidhet në votë dhe miratohet me 22 vota pro/ Vendim “Për autorizimin e Bashkisë Gjirokastrë për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të fondit kullosor me qëllim shfrytëzimin e energjisë së erës duke vendosur aerogjenereatorë”.

Kalohet te pika 8 e rendit të ditës. P/V Për shprehjen e pëlqimit në parim për realizimin e shpronësimeve në zonën e projektit “Rikonstruksion i Fushës së Vjetër të Sportit”.

Z. Golemi : Ne kemi arritur një marrëveshje paraprake me bashkëpronarët dhe ky shpronsim ka të bëjë me investimin në dy terrene sportive në një sipërfaqe rreth 800 m<sup>2</sup> e cila duhet shpronësuar. Miratohet me 22 vota pro pika 8.

Largohet nga mbledhja, Shehaj dhe Novi..

Kalohet te pika 9P/Vendim “Për miratimin e projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA”.

Sqaron znj Koko : Është një marrëveshje që lidhet ndërmjet 61 bashkive dhe 12 qarqeve që ka të bëjë me krijimin e një agjencie që synon ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe përfshin administratën dhe te zgjedhurit, ku 50% të vlerës e mbulon pushteti qendror dhe 50% e mbulon pushteti local. Gjithashtu bashkia Gjirokastrë është në grupine përafrimit të legjislacionit me BE.

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro dhe një kundër z. Brahimi.

Kalohet te pika 10 e rendit të ditës: P/Vendim “Për miratimin e Planit të Menaxhimit për Transportin Publik për vizitorët vendas dhe të huaj në Bashkinë Gjirokastrë”.

Kjo pikë ka kaluar në komision.

z. Golemi: mendoj se në këtë pikë jemi më dobët në shërbimin ndaj turistëve. Pra është një shërbim që duhet ta përmirësojmë . Nga FSHZH I kemi marrë 3 autobusat e parë dhe jemi në pritje edhe për 5 makina të tjera të vogla. Si fillim do të aplikojmë 2 linja. Unaza e madhe dhe “18 Shtatori”- Antigone të cilat kanë të parashikuara oraret e nisjes dhembërritjes.

Linjat egzistuese nuk preken edhe pse ka shume probleme , por kanë kontrata të miratuara 10-vjeçare.

Z. Hilaj: Jam dakord me këtë plan , por mendoj se duhet të sqroni njësitë admin , personat që punojnë me transportin , sepse mund të krijohen konflikte .

Z. Qeli: jam dakord dhe të ketë edhe për qytetarët në të ardhmen.

Z. Golemi: Duhet një rinovim I plotë I flotës së autobusëve të transportit publik

Hidhet në votë dhe miratohet me 19 vota pro P/Vendim “Për miratimin e Planit të Menaxhimit për Transportin Publik për vizitorët vendas dhe të huaj në Bashkinë Gjirokastrë”.





Kalohet te pika shtesë P/Vendim "Për përdorimin e Fondit të Kushtëzuar të Emergjencës Civile për masa parandaluese të rrëshqitjes së shpatit të malit në fshatin Kolonjë".

Këshilltarët ngrenë probleme si: Z. Hilaj: Rruga e tregut të jetë me një sens .

ZNJ. Cacaj : Për njësitë administrative a ka transport public? Gjithashtu shumë mirë që mendohet për turistët , por ka nga njësitë administrative që punojnë këtu dhe nuk ka linja që të kthehen sipas orareve.

Mbyllet mbledhja nga znj Isaraj.

**SEKRETAR I KËSHILLIT**  
Etleva Yzo

**KRYETAR I KËSHILLIT**  
Merita Isaraj

